

VENDIM
Nr. 23, datë 13.1.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 135, DATË 7.3.2018,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 20, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 135, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) fjalia e dytë, e kreut I, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Shërbimi Social Shtetëror ka si mision të sigurojë ofrimin cilësor të shërbimeve për çështjet e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror.”;

b) në kreun II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm, të nëpunësve dhe të punonjësve administrativë të Shërbimit Social Shtetëror, në nivel qendror e rajonal, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Procedura e rekrutimit të drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve kryhet sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për mbrojtjen sociale.”;

ii. pas pikës 5 shtohen pikat 5/1 e 5/2, me këtë përmbajtje:

“5/1. Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së emërohet me urdhër të ministrit përgjegjës për mbrojtjen sociale dhe duhet të plotësojë këto kritere:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë diplomë të arsimit të lartë;

ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos ketë konflikt interesi me detyrën, në përputhje me legjislacionin e konfliktit të interesave.

5/2. Drejtori i Përgjithshëm i SHSSH-së lirohet nga detyra kur:

a) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

c) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

ç) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

d) jep dorëheqjen nga detyra;

dh) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj